



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
K A B I N E T I

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 362937 - [www.moh.gov.al](http://www.moh.gov.al)

Nr. 5015 Prot.

Tirane, më 19/12 2008

U R D H Ë R

Nr. 699 Datë 19/12/2008

PËR BASHKËPUNIMIN ME URDHËRIN E INFERMIERIT

Mbështetur në pikën 3, të nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të neneve 4,5 dhe 7 të ligjit nr.9718, datë 29.04.2007 "Për krijimin e Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë", për rritjen e standartit të kujdesjeve infermjorore si dhe mbrojtjen e publikut nga kequshtrimi i profesioneve të përfshira në këtë urdhër:

U R D H Ë R O J:

1. Të njihen infermierët, mamitë dhe fizioterapeftët e institucioneve publike e private, me ligjin nr. 9718, datë 29.04.2007 "Për krijimin e Urdhrit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë", Statutin e Urdhrit të Infermierit dhe Kodin Etiko-Deontologjik të infermier - mami - fizioterapeftëve, si dhe Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Urdhërit të Infermierit në Republikën e Shqipërisë, duke i bërë pjesë të rregulloreve të brendëshme të institucioneve, si dhe të bashkëpunohet me strukturat qendrore dhe lokale të këtij urdhri.
2. Të mos punësohet në institucionet shëndetësore publike apo private, asnjë infermier - mami - fizioterapeft, pa dokumentin e anëtarësisë të lëshuar nga Urdhri i Infermierit.
3. Të gjithë spitalet rajonale, të krijojnë një ambient pune (një dhomë, me paisjet përkatëse, për funksionimin e Këshillit Rajonal të Urdhrit të Infermierit.
4. Ngarkohen drejtoritë e institucioneve shëndetësore publike si dhe institucionet shëndetësore private, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR  
ANILA GODO

